



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

Himarë , më 20.10.2025

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 11.10.2025.

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, me datë 10.10.2025, në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, dëshirojmë t’ju informojmë për hapat që Bashkia Himarë ka ndërmarrë në këtë drejtim.

Në tetor të vitit 2023, Bashkia Himarë ka marrë shkresën nr. 17960 prot., datë 04.10.2023 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), ku kërkohej shprehja e dakordësisë për nisjen e procedurave ligjore për ngritjen e strukturave për mbrojtjen e konsumatorit pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në vijim, Bashkia Himarë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 4662/1 prot., datë 23.10.2023, duke përcaktuar personat përgjegjës nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve, të cilët do të ndiqnin këtë proces.

Në datën 11.04.2025, përfaqësuesit e caktuar nga institucioni ynë morën pjesë në një trajnim të organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim njohjen më të mirë të dispozitave të Ligjit nr. 9902/2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” dhe të rolit që kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore në zbatimin e tij. Bashkia Himarë konfirmoi pjesëmarrjen me gatishmëri dhe interes për të forcuar më tej kapacitetet institucionale në këtë fushë.

Pas përfundimit të trajnimit, u hartua një relacion informues, me qëllim që çështja e ngritjes së Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorëve të paraqitej për shqyrtim në Këshillin Bashkiak. Megjithatë, duke qenë se aktualisht ndodhemi në periudhë kur nuk mund të ndërhyhet në ndryshimin e strukturës organizative, vendimi për krijimin e kësaj strukture është parashikuar të trajtohet në momentin e rishikimit të ardhshëm të organigramës së institucionit.

Pavarësisht kësaj, Bashkia Himarë ka qenë aktive në fushata ndërgjegjësuere që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve. Një ndër aktivitetet e fundit është zhvilluar në kuadër të 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, ku u shpërndanë fletëpalosje informuese mbi kujdesin që prindërit duhet të tregojnë në zgjedhjen e lodrave për fëmijë, duke theksuar rreziqet e mundshme për shëndetin dhe sigurinë e tyre.

Në përfundim, ju informojmë se Bashkia Himarë mbetet e angazhuar për të përmbushur detyrimet ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve dhe për të vijuar bashkëpunimin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në funksion të ngritjes dhe funksionimit të plotë të strukturës përkatëse.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe për kontributin që jepni në këtë fushë me rëndësi për qytetarët, ju sigurojmë për gatishmërinë tonë për çdo informacion shtesë që mund të nevojitet.

Faleminderit mirëkuptimin.